

Universiteti "Haxhi Zeka" – Strategjia e Ndërkombëtarizimit



| | |
|---|--|
| REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISE | UNIVERSITETI UNIVERZITETI "HAXHI ZEKA" PEJË |
| REKTORATI | |
| Nr. / Br. / No. <u>631</u> | Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>12</u> |
| Data / Datum / Date: <u>26.03.2020</u> Pejë / Peć | |

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA"

STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT E UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" NË PEJË

2020-2024

Pejë, Mars 2020

Universiteti "Haxhi Zeka" – Strategjia e Ndërkombëtarizimit

PËRMBAJTA

| | |
|---|----------|
| 1. HYRJE | 4 |
| 2. MISIONI DHE VIZIONI I UNIVERSITETIT PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR | 4 |
| 2.1. Misioni i UHZ-së..... | 4 |
| 2.2. Vizioni i UHZ-së..... | 4 |
| 3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR NDËRKOMBËTARIZIM | 5 |
| 3.1. Objektivat e përgjithshme..... | |
| 3.2. Objektivat Specifike..... | |
| Aktivitetet për realizimin e objektivave specifike | |
| 3.1.1 Krijimi i mekanizmit funksional dhe kompetent për bashkëpunim ndërkombëtar | |
| 3.1.1.1 Krijimi i rregullatives dhe zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar | |
| 3.1.1.2 Ngritura e kapaciteteve për bashkëpunim ndërkombëtar | |
| 3.1.1.3 Konsolidimi i marrëveshjeve aktuale dhe krijimi i partneritetev të reja ndërkombëtare | |
| 3.1.2 Rritja dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në mobilitet | |
| 3.1.2.1 Mobiliteti i stafit akademik (vajtje/ardhje) | |
| 3.1.2.2 Mobiliteti i studentëve (vajtje/ardhje) | |
| 3.1.2.3 Mobiliteti i stafit administrativ të ZBN-së (vajtje/ardhje) | |
| 3.1.2.4 Shkolla verore ndërkombëtare | |
| 3.1.3 Hulumtimet, projekte, konferencat dhe programet e përbashkëta ndërkombëtare | |
| 3.1.3.1 Hulumtime të përbashkëta individuale dhe institucionale ndërkombëtare | |
| 3.1.3.2 Projekte të përbashkëta ndërkombëtare | |
| 3.1.3.3 Konferenca të përbashkëta universitare ndërkombëtare | |
| 3.1.3.4 Programet e përbashkëta ndërkombëtare | |
| 4. Implementimi i procesit të ndërkombëtarizimit | |
| 5. Përfundim | |

1. HYRJE

Ekziston një ritëm në rritje i ndryshimeve dhe dinamizmit në terma globale dhe ne aspirojmë të veprojmë në mënyrë fleksibile dhe me përgjegjësi në mënyrë që të ofrojmë mundësi të reja dhe risi për akademikët dhe studentët në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Universiteti ynë, ashtu si shumica e Universiteteve, e pranon domosdoshmërinë e ndërkombëtarizimit si mënyrën më të mirë për t'iu përgjigjur kërkesave globale që ndryshojnë me shpejtësi dhe reagimit të nevojshëm për t'u përshtatur me këto ndryshime të jashtme qofshin ato shoqërore apo teknologjike. Procesi i ndërkombëtarizimit do të përfshijë projekte të përbashkëta arsimore, shkëmbim të studentëve dhe shkëmbim të personelit dhe do të krijojë mundësi të reja për ata që janë në kërkim të njohurive dhe përvojave të reja për plotësimin e fushave të tyre të interesit dhe prosperitetit në karrierën e tyre të ardhshme, reflektuese për kontekstet dhe rrethanat e tyre.

2. MISIONI DHE VIZIONI I UNIVERSITETIT PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

2.1. Misioni i UHZ-së

Universiteti "Haxhi Zeka" po përqendron përpjekjet e veta në arritjen e një standardi më të lartë të ndërkombëtarizimit. Misioni i UHZ-së është që të bëhet lider në rajon sa i përket ofrimin të edukimit cilësor dhe kërkimeve hulumtuese, afirmimit të marrëdhënieve akademike me universitetet tjera, ofrimit të kushteve dhe ambientit të favorshëm për të përmirësuar njojuritë shkencore dhe kompetencat profesionale si dhe lëvizja e stafit akademik, studentëve dhe stafit administrativ, në përputhshmëri me nevojat e tyre personale dhe shoqërore.

2.2. Vizioni i UHZ-së

Universitetit "Haxhi Zeka" si vizion të vetin ka që të kontribuojë në zhvillimin edukativ përmes procesit të ndërkombëtarizimit dhe programeve edukative të njoitura ndërkombëtarisht dhe forcimin e pozitës akademike në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Ky vizion do të përbushet duke u mbështetur në bashkëpunim të ngushtë me universitetet dhe institucionet ndërkombëtare, me ndërmarrjet dhe institucionet lokale dhe qeveritare, rritjen e shumëlojshmërisë së studentëve dhe stafit akademik, organizimin e konferencave me karakter lokal dhe ndërkombëtar, si dhe lirisë akademike për stafin akademik dhe studentët, sidomos në aspektin e krijimtarisë.

3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR NDËRKOMBËTARIZIM

3.1. Objektivat e përgjithshme:

Qëllimi i strategjisë është të përcaktojë bazat e ndërtimit të një tradite dhe reputacioni të fortë ndërkombëtar të njojur mirë që do të garantojë një pozicion më të mirë të institucionit në vitet në vazhdim dhe do t'i shërbejë brezave të ardhshëm. Strategjia do të përqendrohet në aktivitetet e lëvizshmërisë, të cilat ofrojnë një mjedis më konkurruesh mbi baza ndërkombëtare dhe drejt një agjende më sfiduese, e cila do të sjellë cilësi dhe përsosmëri duke kapërcyer kufijtë kombëtarë. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit dhe studiuesit do të jenë të barabartë me kolegët e tyre në vendet e BE-së dhe më gjérë duke përfituar nga i njëjtë standard dhe mundësi në nivelin më të lartë, duke i bërë kështu ata të hapur për tregun ndërkombëtar të punës si rezultat i së cilës do të jalin kontribut të mëtutjeshëm në përbushjen e kërkeseve në dimensione dhe trende globale. Në këtë kontekst përveç atyre që kanë përfituar nga përvaja e mobilitetit, aspekte të ndërkombëtarizimit do të përjetojnë edhe ata të cilët nuk kanë qenë pjesë e mobilitetit përmes komunikimeve me studentët dhe stafin të cilët kanë përfunduar mobilitetin dhe janë kthyer në institucionin e tyre.

3.2. Objektivat Specifike:

Strategjia e ndërkombëtarizimit me qëllim krijimin e një profili të besueshëm dhe profesional mbështet përpjekjet e saj posaçërisht në këto drejtime:

Aktivitetet për realizimin e objektivave specifike:

3.2.1: Krijimi i mëkanizmit funksional dhe kompetent për bashkëpunim ndërkombëtar

| Aktiviteti | Përshkrimi: | Periudha | Buxheti |
|--|--|-------------|---------|
| 3.2.1 Krijimi i rregullatives dhe zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar | UHZ do të hartojë dhe miratojë Strategjinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar për periudhën pesëvjeçare, në të cilën do të parashihen në detaje aktivitetet që do të zhvillohen nga UHZ në funksion të rritjes së bashkëpunit dhe partneritetit ndërkombëtar, rritjes së projekteve të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë, rritjes së | Shkurt 2020 | 0.00 |

Universiteti "Haxhi Zeka" – Strategjia e Ndërkombëtarizimit

| | | | |
|---|--|-----------|-------------|
| | <p>mobilitetit ndërkombëtar të stafit akademik dhe të studentëve, etj.. Nga Departamenti ekzistues për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sigurimin e Cilësisë ndahet si e veçantë Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar (ZBN).</p> | | |
| 3.2.2 Ngritja e kapaciteteve për bashkëpunim ndërkombëtar | <p>Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar do të ketë 3 persona si personel, prej të cilëve 1 do të avancohet nga pozita aktuale dhe 2 të tjerë do të punësohen. Kjo zyre do të ketë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 drejtor të zyrës dhe - 2 zyrtarë për bashkëpunim ndërkombëtar (përkatësisht një zyrtar për bashkëpunim ndërkombëtar dhe një zyrtar për projekte ndërkombëtare). <p>UHZ përmes Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar (ZBN) do të përzgjedhë 15 anëtarë të stafit akademik (nga 3 prej secilës njësi akademike) dhe 3 zyrtarët e ZBN-së (gjithsej 18), për të cilët do të ofrojë trajnime nga ekspertë vendorë e ndërkombëtarë në lidhje me rritjen e bashkëpunitit ndërkombëtar dhe ndër-institucional, rritjen e projekteve të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë, rritjen e mobilitetit ndërkombëtar të stafit akademik dhe të studentëve, identifikimin e partnerëve ndërkombëtarë e vendorë, etj..</p> | Mars 2020 | 5x21,600.00 |
| 3.2.3 Konsolidimi i marrëveshjeve aktuale dhe krijimi i | UHZ do të rilidhë dhe konsolidojë marrëveshjet aktuale të cilat i ka pasur me Universitetet dhe institucionet të | | |

Universiteti "Haxhi Zeka" – Strategjia e Ndërkombëtarizimit

| | | | |
|--------------------------------------|---|-------------------|-------------|
| partneriteteve të reja ndërkombëtare | ndryshme si dhe do të identifikojë partnerë të ri për arritjen e marrëveshjeve që janë në interes të të dy palëve qoftë për mobilitet të stafit akademik dhe administrativ, qoftë për projekte të ndryshme ndërkombëtare. | Çdo vit 2020-2024 | 5x20,000.00 |
|--------------------------------------|---|-------------------|-------------|

3.3: Rritja dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në mobilitet

| Aktiviteti | Përshkrimi: | Periudha | Buxheti |
|--|---|-------------------|-------------|
| 3.3.1 Mobiliteti i stafit akademik (vajtje/ardhje) | <p>Në bashkëpunim me universitetet partnere ndërkombëtare, për çdo vit UHZ do ta përkrahë mobilitetin ndërkombëtar të stafit akademik, përfshirë shkuarjen e stafit akademik të UHZ-së në universitetet ndërkombëtare dhe ardhjen e stafit akademik të universiteteve ndërkombëtare në UHZ.</p> <p>Gjatë një viti akademik, së paku 10 persona nga stafi akademik i UHZ-së do të qëndrojnë në universitetet ndërkombëtare, ndërsa së paku 2 persona nga stafi akademik i universiteteve ndërkombëtare do të qëndrojnë në UHZ.</p> | Çdo vit 2020-2024 | 5x30,000.00 |
| 3.3.2 Mobiliteti i studentëve (vajtje/ardhje) | <p>Në bashkëpunim me universitetet partnere ndërkombëtare, për çdo vit UHZ do ta përkrahë mobilitetin ndërkombëtar të studentëve, përfshirë shkuarjen e studentëve të UHZ-në në universitetet ndërkombëtare dhe ardhjen e studentëve të universiteteve ndërkombëtare në UHZ.</p> <p>Gjatë një viti akademik, së paku 5 studentë të UHZ-së do të qëndrojnë në universitetet ndërkombëtare, ndërsa së paku 2 studentë të universiteteve</p> | Çdo vit 2020-2024 | 5x30,000.00 |

Universiteti "Haxhi Zeka" – Strategjia e Ndërkombëtarizimit

| | | | |
|---|---|-------------------|-------------|
| | ndërkombëtare do të qëndrojnë në UHZ. | | |
| 3.3.3 Mobiliteti i stafit administrativ të ZBN-së (vajtje/ardhje) | UHZ përmes Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar (ZBN) do të përgjedhë 15 anëtarë të stafit akademik (nga 3 prej se cilës njësi akademike) dhe 3 zyrtarët e ZBN-së (gjithsej 18), për të cilët do të ofrojë trajnime nga ekspertë vendorë e ndërkombëtarë në lidhje me rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndër-institucional, rritjen e projekteve të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë, rritjen e mobilitetit ndërkombëtar të stafit akademik dhe të studentëve, identifikimin e partnerëve ndërkombëtarë e vendorë, etj.. | Çdo vit 2020-2024 | 0.00 |
| 3.3.4 Shkolla verore ndërkombëtare | UHZ do të bëj të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizmin e Universitetit Veror Ndërkombëtar i UHZ-së, i cili do të organizohet çdo vit, në kohën e pushimeve verore. Në kuadër të këtij universiteti veror do të ofrohen kurse të ndryshme në gjuhën angleze nga profesorë të UHZ-së, të universiteteve tjera vendore dhe nga universitete ndërkombëtare. Kurset që do të organizohen do të jenë kryesisht në lidhje me tema aktuale nga fushat e studimit në UHZ dhe tema që promovojnë vlerat dhe traditën e UHZ-së dhe të rajonit të Dukagjinit. Gjithashtu, studentët vijues do të jenë vendorë dhe ndërkombëtarë. Kreditë e fituara nga studentët gjatë universitetit veror do të jenë të | Çdo vit 2020-2024 | 5x12,000.00 |

Universiteti "Haxhi Zeka" – Strategjia e Ndërkombëtarizimit

| | | | |
|--|--|--|--|
| | <p>transferueshme në universitetet e tyre respektive.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të Universitetit Veror do të organizohen edhe aktivitete të shumta sociale, kulturore, sportive e rekreative për të gjithë pjesëmarrësit.</p> | | |
|--|--|--|--|

3.4: Hulumtime, projekte, konferencat dhe programet e përbashkëta ndërkombëtare

| Aktiviteti | Përvizimi: | Periudha | Buxheti |
|---|--|--|--|
| 3.4.1 Hulumtime të përbashkëta individuale dhe institucionale ndërkombëtare | Për çdo vit UHZ do të përkrahë realizimin e hulumtimeve shkencore, të cilat do të realizohen në bashkëpunim mes disa profesorëve të UHZ-së dhe disa kolegëve të tyre nga universitete ndërkombëtare. | Çdo vit 2020-2024 | 5x40,000.00 |
| 3.4.2 Projekte të përbashkëta ndërkombëtare | <p>Përmes Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar, gjatë periudhës pesëvjeçare UHZ do të jetë partner zbatues i 5 projekteve të përbashkëta me universitete ndërkombëtare, prej të cilave 2 projekte do të hartohen dhe udhëhiqen nga UHZ, ndërsa në 3 projekte të tjera do të jetë partner zbatues. Këto projekte do të janë të fushave të ndryshme, nga të cilat përfiton UHZ, stafi dhe studentët e tij. Projektet, përveç tjerash, do të janë në lidhje me hartimin dhe akreditimin e programeve të reja, programeve të përbashkëta dhe për zhvillimin strategjik të institucionit.</p> <p>Për zbatimin e këtyre projekteve do të sigurohen donacione ndërkombëtare nga skemat ekzistuese në dispozicion,</p> | 2020 projekt partner 2021 projekt partner 2022 projekt partner 2023 projekt bartës 2024 projekt bartës | 100,000.00 100,000.00 100,000.00 100,000.00 100,000.00 |

Universiteti "Haxhi Zeka" – Strategjia e Ndërkombëtarizimit

| | | | |
|---|---|--|---|
| | por sipas nevojës, UHZ do ta përkrahë financiarisht këtë bashkëpunim me buxhetin e veçantë të ndarë për këtë qëllim | | |
| 3.4.3 Konferenca të përbashkëta universitare ndërkombëtare | <p>Me qëllim të këmbimit të ideve dhe të rejave të fundit Në fusha të ndryshme me kolegë dhe hulumtues të ndryshëm ndërkombëtarë, UHZ do të jetë organizator i konferencave ndërkombëtare si dhe do të marr pjesë në konferenca të ndryshme si pjesë esenciale e jetës akademike.</p> | Çdo vit 2020-2024 | |
| 3.4.4 Programe të përbashkëta studimore me partnerë ndërkombëtarë | <p>Në bashkëpunim me universitetet partnere vendore e ndërkombëtare gjatë periudhës pesëvjeçare UHZ do të përgatisë, akreditojë dhe do të fillojë të zbatojë së paku 3 programe të përbashkëta të studimeve me universitete ndërkombëtare (1 PhD, 1 MA dhe 1 BA).</p> <p>Këto programe studimi do të jenë në gjuhën angleze, me staf akademik nga UHZ dhe universitetet partnere ndërkombëtare, si dhe me studentë vendorë e ndërkombëtarë.</p> <p>Për zbatimin e këtyre programeve do të sigurohen donacione ndërkombëtare nga skemat ekzistuese në dispozicion, por sipas nevojës, UHZ do ta përkrahë financiarisht këtë bashkëpunim me buxhetin e veçantë të ndarë për këtë qëllim</p> | <p>2020 - Program i përbashkët master FAG (me UP)</p> <p>2021 - Program i përbashkët bachelor FB (Universitetin e Srajvës)</p> <p>2022 - Program i përbashkët PhD FB (Me universitetin e Maltës, Zagrebit dhe Tetovës)</p> | <p>0.00</p> <p>3,500.00</p> <p>3,500.00</p> |

Universiteti "Haxhi Zeka" – Strategjia e Ndërkombëtarizimit

4. Implementimi i procesit të ndërkombëtarizimit

Ekziston mekanizmi, burimet dhe stafi kompetent për organizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndër-institucional (Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Drejtori, zyrtari për bashkëpunim dhe zyrtari për projekte) e cila do të garantojë një implementim të sigurt të të gjithë procesit dhe përbushjen e objektivave të veta. Kjo zyre ka staf të trajnuar profesional që është në gjendje të adresojë të gjitha nevojat dhe kërkesat e studentëve dhe stafit akademik që kanë të bëjnë me aktivitetet ndërkombëtare. Përfshirja e të gjitha niveleve dhe fushave të Universitetit do ta bëjë Universitetin "Haxhi Zeka" konkurrues, tërheqës dhe do të inkurajojë studentë, pedagogë dhe studiues të kualifikuar vendorë dhe ndërkombëtarë të bëhen pjesë e programeve dhe marrëveshjeve të mobilitetit. Strategjia lehtëson qasjen e stafit akademik dhe studentëve në mundësi informacioni dhe lëvizshmërie dhe siguron një mekanizëm të suksesshëm për programet e tyre të shkëmbimit.

5. Përfshirja dhe bashkëpunimi akademik me Diasporën Kosovare

Duke pasur parasysh që një numër i madh i Diasporës Kosovare (si kontribuuës të rëndësishëm në Kosovë) jetojnë në vendet e huaja dhe ato paraqesin një faktor të rëndësishëm në jetën dhe aktivitetet e përditishme të Kosovës, Universiteti njeh potencialin që ata kanë dhe do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të favorizuar marrëdhënet me Diasporën dhe krijimin e kushteve të qëndrueshme për të përfshirë diasporën si partner aktiv në zhvillimin e Universitetit.

6. Alumni

Universiteti është i vetëdijshëm për potencialin e madh që ka midis studentëve të tij, dhe angazhohet seriozisht për të krijuar përfitime nga marrëveshjet e shkëmbimit të Universitetit me Universitete dhe institucione të tjera. Çfarëdo lloj bashkëpunimi interaktiv është i mirëseardhur pas përfundimit të arritjeve të tyre të njobura ndërkombëtarisht. Në një mënyrë apo tjetër, alumni mund të informohet për veprimtaritë e Universitetit dhe të mbajë një lloj lidhje speciale, si dhe të mbetet mbështetës i angazhuar dhe besnik në përparimin e Universitetit. Përveç kësaj për ofrimin e përkrahjes profesionale që ata kanë fituar në periudha të ndryshme kohore në përvojat e tyre, ato mund të shërbejnë si promovuesit më të mirë për studentët e tjerë që dëshirojnë të ndjekin studimet e tyre jashtë vendit.

7. Transparenca dhe mundësítë e barabarta

Universiteti "Haxhi Zeka" – Strategjia e Ndërkombëtarizimit

Procesi i ndërkombëtarizimit bazohet në parimet e transparencës dhe barazisë. Të gjithë do të kenë qasje të pakufizuar në informacionin e duhur, dhe të gjithë aplikantët janë të barabartë. Me këtë besojmë se do të mundësohet dhe thjeshtësohet lëvizja e njerëzve si dhe do të rritet besueshmëria dhe nxitë bashkëpunimi i mëtutjeshëm ndërmjet studentëve dhe Universitetit. Kjo do t'i ndihmojë ata që të kuptojnë në mënyrë të drejtë zhvillimet aktuale si dhe marrjen e vendimeve të pavarura me bindjen dhe besimin që kërkesat e tyre do të realizohen në mënyrë të paanshme.

8. Përfundim

Duke qenë se janë përcaktuar objektivat specifike dhe aktivitetet për arritjen e këtyre objektivave, por edhe rëndësinë që ka procesi i ndërkombëtarizit në avancimin dhe forcimin e mëtutjeshëm të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, si përfundim cekim që mbësim thellësisht të përkushtuar në punën tonë dhe mbarëvajtjen e këtij procesi.